

VENDIM
Nr.70, datë 21.1.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS ARRAS, TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Arras, të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Arras, të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr.705, datë 19.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Arras, të qarkut të Dibrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Arras për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave Në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
13-15	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
19	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
20-36	Varreza publike	Në pronësi
172-197	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
137,138,140,141,143,144,146, 148,149,151,152,154,155,157, 158,160,161	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
139,142,145,147,150,153,156, 159,162,163-170 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit. (toka inproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
198,199	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës - kanalizimeve	Në pronësi